

Mbi Petrit Imamin: Intelektual në kohërat e errëta ose demistifikimi i lajthitjeve

Për Petrit Imamin kam dëgjuar qysh në kohën e studimeve në vitet '70, por me atë nisa të shoqërohesh kah fundi i viteve '90 të shekullit të kaluar, kur shpesh isha mysafir në apartamentin e tij në Vozhdovac, në rrugën "Trishe Kaçllereviqa".

Bisedonim me orë të tëra për tema të ndryshme nga politika, kultura, historia, gjuha...për të cilat ai kishte njohuri të madhe, dhe atë që nuk e dinte e plotësonte ose e konfirmonte gjatë bisedës. Ishte një erudit i vërtetë, inteligjent, i kulturuar, i sinqertë, i edukuar, mikpritës, i këndshëm, i përzemërt, me integritet të lartë profesional e intelektual. Thjesht, ishte kënaqësi, privilegj dhe shkollë të rrije dhe bisedoje me të. Njohës i mirë i rrjedhave dhe rrethanave në Serbi, Kosovë, Shqipëri dhe mbarë hapësirën jugosllave, i atyre kulturore, i ngjarjeve historike, njohës i shkëlqyeshëm i profesionit të vet prej pedagogu në Fakultetin e Arteve Dramatike, njohës i madh i leksikut të gjuhës shqipe dhe serbokroate, hulumtues i palodhshëm dhe i denjë i arkivave të qytetit të Beogradit, njeri me shumë miq e shokë të profesioneve dhe moshave të ndryshme.

Edhe pse me vokacion profesor i dramaturgjisë, Petriti gati njësoj i ka njohur edhe rrjedhat politike e kulturore e veçmas historinë e popullit shqiptar dhe serb, që nga kohët e lashta e deri në ditët e sotme. Ka poseduar njohuri të madhe lidhur me shqiptarët në Beograd që nga fundshekulli XIX, madje i ka poseduar edhe kopjet e numrave të parë të gazetës "Albanija" të botuar në Beograd, më 1903, në gjuhën shqipe, por me shkronja cirilike. Për këto çështje ka pasur literaturë të madhe të trashëguar nga i ati, por edhe shumë informata të nxjerra nga arkivat dhe nga takimet e bisedat me personalitete të ndryshme, veçmas pjesëmarrës të LNÇ, politikanë, historianë, gazetarë, regjisorë, aktorë... dhe çdo gjë e ka shënuar me pedanteri dhe e ka analizuar mirë. Prandaj, nuk ka qenë lehtë të debatosh me një njeri të tillë me dije enciklopedike, por shumë modest dhe joimponues. Mirëpo, e ka pasur një mangësi që kurrë nuk ka dashur të prononcohet për mediat mbi gjërat që i njeh, e madje as nuk ka pranuar të marrë pjesë në përrurimin e librave të tij, sidomos të librit antologjik "Serbët dhe shqiptarët ndër shekuj." Më kujtohet edhe fakti se derisa isha duke punuar në redaksinë shqipe të Radio Jugosllavisë, fillimi i viteve 80', ishte Petrit ai, i cili na i zgjidhje dilemat rreth ndonjë fjale të panjohur gjatë përkthimeve, dhe këtë ndihmë e bënte pa përtesë. Gjithashtu, ka pasur raporte shumë të afërta me studentët e vet, për çka edhe banesën e pati shndërruar në çerdhe ku studentët shkonin në konsultime e këshillime.

* Fahri Musliu (1948,) është gazetar në pension. Ka studiuar gazetarinë në Beograd prej ku ka qenë 38 vjet korrespondent për mediet në gjuhën shqipe në Kosovë (Rilindja, Bujku, Zëri dhe Radiotelevizioni I Kosovës -RTK) si dhe korrespondenti shumëvjeçar i Zërit të Amerikës, BBC. Ka shkruar për shumë media në gjuhën serbokroate (Borba, Nasha borba, Vjesnik, Danas). Ka disa vite që shkruan për portalin e TV Al Jazeera Balkans, dhe emrret me punë publicistike. Ka shkruar dhe botuar disa libra dokumentar në shqip e serbokroatisht, përfshirë edhe monografinë voluminoze "Bekim Fehmiu".

Petrit Imami është lindur më 11 shtator të vitit 1945, në Prizren. Për shkak të nevojave për përkthyes nga gjuha shqipe, familja e tij, në nëntor të atij viti, u transferua në Beograd. Babai Sitki Imami, i lindur në Gjakovë, ka punuar si përkthyes në emisionet e gjuhës shqipe të programit për botën e jashtme të Radio Beogradit. Ai i ka takuar gjeneratës së parë të letrarëve shqiptarë të Kosovës, të cilët më 1945 fituan mundësinë të shkruajnë dhe publikojnë në gjuhën amtare .

Sitkiu ka qenë edhe bashkëpunëtor në hartimin e fjalorit shqip-serbokroatisht dhe anasjelltas, në botimin e Institutit Albanologjik të Prishtinës. Nëna e Petritit, Matilda Ale - amvise, me kombësi hungareze, e cila vdes herët dhe Petriti mbetet në përkujdesjen e babës i cili kurrë më nuk është martuar. Nga i ati ai i ka trashëguar kultin e punës, kulturën e përgjithshme, edukatën, respektin , përgjegjësinë, si dhe një bibliotekë shumë të pasur me libra .

Petriti ka jetuar në Beograd deri në vdekjen e tij, më 30.05.2019 kur edhe është kremuar. Ka qenë i martuar me dr. Naile Mala- Imami, docente në Katedrën e Albanologjisë të Fakultetit Filologjik, në Beograd, me të cilën e kanë djalin Aurelin.

Petriti është shkolluar në gjuhën serbokroate dhe pas gjimnazit regjistrohet në Fakultetin e Shkencave Politike, sipas dëshirës së babait, por pas vitit të parë ikën nga aty dhe regjistrohet në Dramaturgjia të Akademisë për Teatër, Film e TV, ku diplomon më 1974.

Ai i ka takuar gjeneratës së artë të studentëve shqiptarë të cilët, me numër të madh; studiuuan në fakultetet e ndryshme të Universitetit të Beogradit.

Ka punuar si dramaturg në Televizionin e Prishtinës (TVP) gjatë viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, duke bashkëpunuar në përgatitjen e një numri të madh të dramave televizive dhe emisioneve dokumentare, të xhiruara nga TV Prishtina.

Dallohet si autor i serisë televizive dhe filmit artistik “Era dhe lisi” (1979) dhe “Lumi i tërbuar” (1983) të TVP dhe Kosova Filmit, të punuar sipas romanëve me të njëjtin emër të shkrimtarit dhe politikanit, Sinan Hasani . Filmi “Era dhe lisi” u shpërblyen me renën e artë për skenar në Festivalin e filmit në Pula të Kroacisë, më 1979. Gjatë viteve ‘70 ka publikuar tekste profesionale dhe kritika filmike në revistën për letërsi e kulturë, “Fjala”, të Prishtinës..

Si bashkëpunëtor profesionist me honorar, më 1978 angazhohet në Akademinë për Teatër, Film e TV në lëndën Skenari për film dhe televizion, ku punon deri në pensionim, më 2012, dhe gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe shef i katedrës së skenarit.

Për nevojat e mësimi për lëndën Skenari filmik dhe televiziv e ka përgatitur librin “Hrestomatija filmskog scenarija u teoriji i praksi I-II”/ 1978-1083 (Hrestomatinë



Petrit Imami (1945-2019)

e skenarit filmik në teori dhe praktikë I-II), në botimin e Universitetit të arteve në Beograd. Ka botuar “Englesko-srpski rečnik filma i televizive /NNK, 2002, (Fjalorin anglisht-serbokroatisht të filmit dhe të TV), “Beogradski frajerski rečnik (NNK, 2000, 2003, 2007) i vetmi fjalor i këtij lloji në Serbi, dhe “Dramaturgija umetnickog filma” / (NNK, 2011, (Dramaturgija e filmit artistik). Ka qenë anëtar i redaksisë dhe autor i mbi 200 pasazheve të Leksikut të nocioneve filmike dhe televizive I-II (1993, 1997), në botimin e Universitetit të arteve dhe Nauçna knjiga në Beograd. Tekstet profesionale mbi dramaturginë e filmit i ka publikuar në “Zbornik Fakulteta dramskih umetnosti” dhe në revistat e tjera. Librin “Origjina e fjalëve në gjuhën shqipe” e ka botuar në Prishtinë më 2011, nga shtëpia botuese “Buzuku”.

Padyschim se kryevepra e angazhimit dhe hulumtimeve të Petritit është libri trevëllimesh, “Serbët dhe shqiptarët ndër shekuj” i botuar në serbokroatisht dhe shqip, një studim brilant, objektiv e faktik, i zhveshur nga çdo ngarkesë nacionaliste, paragjykime, propagandë apo njëanshmëri, çfarë nuk ekziston deri më sot në historiografinë shqiptare dhe serbe, që dëshmon për njohjen e mrekullueshme dhe të thellë të raporteve midis këtyre dy popujve.

Lidhur me përgatitjen e këtij libri, Petriti i jep arsyt e veta: “Nevoja për ta shkruar librin ‘Serbët dhe shqiptarët ndër shekuj’ ka lindur në mua nga motivet e thella që të ballafaqohem me historinë e këtyre dy popujve të cilët jetojnë në fqinjësi mbi një mijë vjet. Më ka interesuar t’i njoh raportet e tyre: çfarë kanë qenë, çka i ka afruar dhe çka i ka larguar njërin nga tjetri, çka i ka shtyrë në miqësi dhe në armiqësi. Jam përpjekur t’i përfshij rrjedhat e brendshme dhe të jashtme në vertikalen historike, që kanë ndikuar në sjelljet e pjesëtarëve të tyre, të udhëheqësve dhe njerëzve të zakonshëm. Që të futëm në këtë temë, më së shumti kanë ndikuar ngjarjet e viteve ‘80, të shekullit të kaluar, kur nisi shpërbërja dhe rrënimi i Jugosllavisë socialiste.

Ai me këtë studim voluminoz është përpjekur t’i demistifikojë stereotipat e letërsisë dhe historiografisë serbe, të cilat, në fillim të shekullit XX, shqiptarët kryesisht i përmendin si popull i “pacivilizuar.” Një imazh të tillë për ata e kanë krijuar politika dhe propaganda antishqiptare e regjimeve në pushtet, e nën ndikimin e kësaj kanë rënë edhe disa shkrimtarë të njohur. Petriti thoshte se shembull më i mire për këtë është vjersha lirike “Simonida” (1907) e Milan Rakiqit, i cili për “sytë e saj të gërmuar” në afreskun e njëjtë, në manastirin e Graçanicës, i ka shkruar vargjet: “Arbanasi me brisk t’i nxori sytë”....

Mirëpo, për dallim nga Milan Rakiqi, thotë Petriti, për shqiptarët kanë shkruar shumë pozitivisht në shekullin XIX i ati i tij, Mita Rakiq, shkrimtar e politikan, si dhe gjyshi i tij nga nëna, historiografi i njohur Milan Gj. Miliqeviq.

“Nisur nga kjo u zhyta në libra, revista profesionale, gazeta të përditshme, revista javore e mujore nëpër biblioteka të Beogradit, si dhe në Bibliotekën Popullore e Universitare, Matica Srpska të Novi-Sadit dhe të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve (SANU). Jam vënë në kërkim të përgjigjeve dhe të dhënave mbi temat dhe personalitetet e caktuara nëpër arkiva të ndryshme, më së shumti në Arkivin Shtetëror të Serbisë dhe Arkivin Qendror të SANU. I jam përmbajtur parimit gazetaresk “se nuk është tmerr nëse gazetari nuk di diçka, veç është tmerr në qoftë se gazetari nuk e di kush e di, dhe kam mësuar gjëra për të cilat deri atëherë s’i kam ditur fare”, thotë ai.

Dorëshkrimin e parë të titulluar “Raportet kulturore shqiptaro-serbe”, Petriti e pati publikuar në gazetën e pavarur “Danas” (Beograd), më 1998, si fejtton, në 19 vazhdime, i cili bëri jehonë të madhe te lexuesit. Për këtë shkak drejtori i Radios B92, Veran Matiq, si botues, i ofron që këtë dorëshkrim ta publikojë si libër me të njëjtin

titull, që edhe ndodhi, por policia e regjimit të Slobodan Milosheviqit të futët me dhunë në lokalet e radios dhe ta asgjësojë tërë tirazhin. Pas ndryshimeve demokratike në Serbi, në tetor të vitit 2000, Matiqi vendos ta ribotojë librin, por me plotësime me më shumë material mbi raportet politike. Petriti thotë se këtë e ka shkruar shpejt dhe libri doli nga shtypi në fund të atij viti, por ka vërejtur se ishin përvjedhur shumë gabime.

Por pas 16 vjetësh me intensitet të ndryshëm kam vazhduar, në spektër të ndryshëm, të studioj më ngadalë raportet serbo-shqiptare. Veçmas pjesën politike dhe historike dhe qëllimi ishte demistifikimi i lajthitjeve të përhapura historike. Frytet e kësaj pune gjenden në brendi të tri vëllimeve të këtij libri që mban titullin “Serbët dhe shqiptarët ndër shekuj” e që përfundon me shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

“Libri i Petritit ‘Serbët dhe shqiptarët ndër shekuj’ është i vetmi i këtij lloji në gjuhën serbe dhe shqipe, i cili në mënyrë objektive, pa anime dhe me argumente i trajton raportet shekullore midis këtyre dy popujve. Kjo qasje autorin e bën të veçantë, sepse dëshmon se librat mund të shkruhen ndryshe, pa paragjykime, nënçmime, përbuzje, pa etiketa, mosrespektime dhe urrejtje, dhe qasjet e tilla mund të ndihmojnë që njerëzit të kuptohen më lehtë t’i tejkalojnë mosmarrëveshjet e të ndërtojnë mirëbesim e respektim”, ka shkruar në recensionin e librit, shkrimtari dhe dramaturgu, Filip David.

Në këtë mënyrë Petriti i ka thyer të gjitha paragjykimet dhe ngarkesat që ekzistojnë tek historianët dhe intelektualët e të dyja palëve. Ai është shembull i intelektualit të vërtetë në kohërat e errëta, sepse e ka bërë atë që ka ditur më së miri dhe këtë e ka punuar në mënyrën më të mirë, duke kërkuar lidhjet që i kanë afruar e jo ato që i kanë ndarë këta dy popuj.

Prandaj, lirisht mund të thuhet se Petriti me jetën dhe veprat e veta, si intelektual i vërtetë i cili pareshtur lufton vetëm për të vërtetën, ka hedhur themelet për njohje më të mirë të këtyre dy popujve në kohët e sotme dhe të ardhshme, dhe për këtë meriton respektimin e madh të popullit serb dhe shqiptar.

Kurse botuesi i librit Veran Matiq thotë: “S’ka dyshim se libri ‘Serbët e shqiptarët ndër shekuj’, është vepër jetike e Petritit, por edhe vepër jetike e të gjithë neve që përpiqemi ta njohim njëri-tjetrin, të mësojmë diç më shumë mbi marrëdhëniet e serbëve dhe shqiptarëve, nga momenti kur janë takuar për here të parë deri më sot. E ka shkruar Petriti, secilën nga këta libra, duke mos heshtur asgjë, pa vetëcensurë, duke e plotësuar tekstin e vet nga burimet më të ndryshme, duke u përpjekur të prezantojë fakte për secilën anë, pa imponimin e konkludimeve”, ka cekur ai.

Petriti i ka përjetuar rëndë çmendjen nacionaliste, urrejtjen, konfliktet, luftën dhe të këqijat që ndodhën gjatë dekadave të fundit në hapësirën ish-jugosllave, veçmas krimet në Kosovë që e kanë brejtur nga brenda. Por njëkohësisht kjo e shtyri që të punojë intensivisht dhe pa pushuar në hartimin e veprës e cila, me përmbajtjen e vet, objektivitetin, gjithëpërfshirjen dhe kompetencën - do të jetë bazë mbi të cilën është e mundshme dhe e domosdoshme të ndërtohen raportet midis dy popujve me trashëgimi të begatshme, sikur ka dashur vazhdimisht të dëshmojë se nuk jemi aq të këqij si njerëz, sikur që krijojmë përshtypjen për vetveten me anë të dhunës dhe urrejtjes.

Trashëgimia e Petritit, biblioteka dhe arkiva e tij, dorëshkrimet, veprat e shkruara e të pashkruara janë thesar i përbashkët. Prandaj edhe serbët, edhe shqiptarët duhet patjetër ta shfrytëzojnë këtë thesar të çmuar në mënyrën më të mirë të mundshme, në përpjekjet për t’i përmbushur angazhimet fisnike në raportet tona serbo-shqiptare, dhe ndriçimin e tyre me argumente i ka investuar ai.